



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2021:132153  
Datë: 26.06.2022  
Numri i dokumentit: 03170766

C.nr.934/21

GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëseve S. M., Sh. S. dhe Sh. Ll., që të gjitha me vendbanim në Gjakovë, të cilat me autorizim i përfaqëson i autorizuari Ilir Rogova– avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale e Arsimit, e përfaqësuar nga Dardan Bakija, me autorizim, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe atë në vlerë të kontestit 2,030.00 Euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik të mbajtur, në prezencën e të autorizuarit të paditëseve dhe të përfaqësuesit të paditurës, me datë 13 qershor mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses S.M. nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses S.M. në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën kohore 02.12.2019 deri më 17.11.2021, për 340 ditë të pranisë në punë, të i'a paguajë shumën prej 680.00.-€ (gjashtëqind e tetëdhjetë euro) me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 23.06.2021 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses Sh.S. nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses Sh.S. në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën kohore 02.12.2019 deri më 17.11.2021, për 340 ditë të pranisë në punë, të i'a paguajë shumën prej 680.00.-€ (gjashtëqind e tetëdhjetë euro) me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 23.06.2021 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadija e paditëseve Sh.Ll.nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses Sh.Ll. në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën kohore 02.12.2019 deri më 17.11.2021, për 335 ditë të pranisë në punë, të i'ua paguajë shumën prej 670.00.-€ (gjashtëqind e shtatëdhjetë euro) me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 23.06.2021 (datë e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që këtu paditëseve S.M., Sh. S. dhe Sh. Ll., që të gjitha me vendbanim në Gjakovë, të i'ua kompensojë shpenzimet procedurale në shumën e përgjithshme prej 498.20.-€ (katërqind e nëntëdhjetë e tetë euro e njëzet cent), në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Paditëset S. M., Sh. S.dhe Sh. Ll., që të gjitha me vendbanim në Gjakovë, përmes të autorizuarit të tyre av. Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, në këtë gjykatë me datë 23.06.2021, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, duke theksuar se të njëjtat janë të punësuar pranë të paditurës dhe atë në shkollën “Y. M.” në Gjakovë, ku kanë punuar pa ndërprerje që nga viti 2019 e tutje. Që nga data 04.12.2019, e paditura ka pasur obligim që paditëseve të iu kompensojë shumën prej 2 euro për çdo ditë pune, e kjo në emër të shujtave. Meqë e paditura nuk e ka bërë këtë, paditëset kanë iniciuar kontest përmes kësaj padie. I autorizuari i paditëseve me parashtrësën e datës 23.05.2022 ka bërë precizimin e kërkesëpadiës në aspektin objektiv, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadija e paditëseve dhe të detyrohet e paditura që paditëseve S. M. dhe Sh. S., secilës për 340 ditët e pranisë në punë, të iu kompensojë shumën prej 680.00 euro, ndërsa për paditësen Sh. Ll., për 335 ditët e pranisë në punë, shumën prej 670.00 euro. I njëjti në fjalën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe parashtrësës së datës 23.05.2022, e paditura ka ushtruar përgjigje në padi, mirëpo e njëjta është në tërësi deklarative. Sa i përket Qarkores Buxhetore 2022/01 e datës 14.05.2021, për të njëjtën ka vlerësuar se nuk ka relevancë të të provuarit për shkak se e njëjta nuk është bazë për refuzimin e padisë. Objekti i këtij kontesti ka të bëjë me kompensimin e parave të ushqimit, obligim ky që për të paditurën buron nga Kontrata Kolektive e vitit 2017 dhe ajo e vitit 2021. Vlen të theksohet fakti se paditëset edhe më herët për periudhë tjetër kohore i kanë realizuar suksesshëm parat e shujtës, pikërisht përmes kontestit gjyqësor para kësaj periudhe, përkatësit para datës 02.12.2019, prandaj të njëjtat kanë pritje legjitime se do të kompensohen sërish për pjesën e pa realizuar. Ka shtuar se nga provat e administruara në mënyrë të pa dyshimtë është vërtetuar baza juridike e kërkesë padisë si dhe lartësia e të njëjtit, ashtu që Gjykatës i ka propozuar që të njëjtën ta aprovoi në tërësi si të bazuar, duke e detyruar të paditurën që paditëses së parë dhe të dytë për 340 ditë punë të i'au paguaj nga 680,00 euro ndërsa paditëses së tretë për 335 ditë punë të i'ua paguaj shumën prej 670,00 euro, të gjitha me kamatën ligjore

prej 8 % duke filluar nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të përmbarimit.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë: taksën gjyqësore për padi në vlerë prej 20.00.-€, për përpilimin e padisë prej 208,00.-€ dhe për përfaqësim në një seancë gjyqësore nga 270.20 €, apo në shumën e përgjithshme 498.40.-€.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarit të saj Dardan Bakija, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 24.05.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve pasi që MASHT-i dhe SBASHK-u, nuk janë të angazhuar për t'i informuar dhe ndihmuar Komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e kësaj kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit etj., ashtu që ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar.

Përfaqësuesi i të paditurës në fjalën e dhënë në seancën për shqyrtimin kryesorë të çështjes dhe në fjalën e tij përfundimtare, ka deklaruar se Kontrata Kolektive e Arsimit e nënshkruar në mes të MASHT-it e datës 22.01.2021 në nenin 47 të saj, ka shfuqizuar kontratën kolektive të datës 18.04.2017, ashtu që sipas nenit 35 par. 7 të kësaj kontrate si dhe lidhur me këtë dhe dispozitat kalimtare të nenin 45 par.1 nuk është bërë kurrfarë ndihmese në planifikimin e buxhetit për realizimin e kërkesave lidhur me zbatimin e dispozitave të nenit 35 par.7 deri sa të krijohen mundësitë financiare në Buxhetin e Republikës së Kosovës por jo ma vonë se viti 2023, po ashtu edhe sipas Qarkores Buxhetore 2022/01 i datës 14.05.2021, te granti specifik të arsimit para universitar, nuk është paraparë mundësia për realizimin e kësaj të drejte. Sa i përket precizimit ka deklaruar se parashtesën e datës 23.05.2022 e kanë pranuar brenda afatit dhe të njëjtën nuk e ka kundërshtuar. Nga të lartcekurat, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesë padinë e paditëses si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, ashtu që i ka propozuar Gjykatës që të merr Aktgjykim dhe të njëjtën ta refuzojë si të pa bazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Kontrata e punës për paditësen S. M., e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar me nr. leg. Nr. .../.... i datës 25.02.2021, Kontrata e punës për paditësen Sh. S. e lëshuar nga Komuna Gjakovës, Drejtoria e Arsimit në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar me nr. leg.../.. e datës 02.03.2021, si dhe kontrata me numër leg.../.. e datës 02.03.2021, Kontratat e punës për paditësen Sh. Q., të lëshuara nga Komuna e Gjakovës, Drejtoria e Arsimit në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar me nr.Leg. .../.... dt.26.03.2021 dhe me numër Leg.../... e datës 24.02.2021, Vërtetimi i lëshuar për te gjitha paditëset nga SHMU” Y.M.” në Gjakovë, me numër të protokollit ..../.... i datës 28.03.2022.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore,( më tutje LPK-së), arriti në përfundim se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga Kontrata e punës për paditësen S. M., e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar me nr. leg. Nr. .../... i datës 25.02.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja S. M. është në marrëdhënie pune te e paditura, Komuna e Gjakovës–Drejtoria e Arsimit, respektivisht në Institucionin Arsimor: Shkolla “Y.M.” në Gjakovë.

Nga Kontrata e punës për paditësen Sh. S. e lëshuar nga Komuna Gjakovës, Drejtoria e Arsimit në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar me nr. leg..../. e datës 02.03.2021, si dhe kontrata me numër leg..../. dt.02.03.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja Sh.S. është në marrëdhënie pune te e paditura, Komuna e Gjakovës–Drejtoria e Arsimit, respektivisht në Institucionin Arsimor: Shkolla “Y. M.” në Gjakovë.

Nga Kontratat e punës për paditësen Sh. Q., të lëshuara nga Komuna e Gjakovës, Drejtoria e Arsimit në versionin e fotokopjuar, e vërtetuar me nr.Leg. .../... e datës 26.03.2021 dhe me numër Leg..../.... e datës 24.02.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja Sh.Q. është në marrëdhënie pune te e paditura, Komuna e Gjakovës–Drejtoria e Arsimit, respektivisht në Institucionin Arsimor: Shkolla “Y.M.” në Gjakovë.

Nga Vërtetimi i lëshuar për të gjitha paditëset nga SHMU” Y.M.” në Gjakovë, me numër të protokollit .../... i datës 28.03.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditëset punojnë në Institucionin e lartpërmendur dhe nga data 04.12.2019 deri me datë 17.11.2021, paditësja S. M. dhe Sh. S. kanë punuar secila nga 340 ditë pune, ndërsa paditësja Sh. Ll. ka punuar 335 ditë pune.

Në nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës 01/B e cila ka hyrë në fuqi me datën 22.01.2021, në mënyrë identike parashihet se *“Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore.*

Gjykata nga administrimi i provave të cilave prova dhe iu fali besimin e plotë, gjeti se paditëset janë në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Shkollën Filllore “Y.M.” në Gjakovë, dhe se për periudhën kohore nga data 04.12.2019 deri me datë 17.11.2021 në këtë institucion arsimor, paditësja S.M. dhe Sh. S. kanë punuar secila nga 340 ditë pune, ndërsa paditësja Sh. Ll. ka punuar 335 ditë pune. Këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga Vërtetimi i lëshuar për të gjitha paditëset nga SHMU” Y.M.” në Gjakovë, me numër të protokollit .../... i datës 28.03.2022. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditëseve nuk iu ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me dispozita ligjor të lartëcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri

përlllogaritjen në atë mënyrë që ditët e kaluara në punë të paditëseve i ka shumëzuar me 2, duke i'ua njohur shumën si në pikën I, II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes mori parasysh edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Sipas neneve të lartë cituara të Kontratë Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësve dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në *“Gazetën Zyrtare”* të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditëseve, të iu paguajë vlerën e precizuar të kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pretendimet e të paditurës se nuk ka planifikim buxhetor për këto kompensime, i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditëset në rrugë gjyqësore kanë filluar të realizojnë një të drejtë ligjore që i garanton Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe ajo e vitit 2021 kurse mungesa e buxhetit të paditurës, nuk mund të ketë për efekt vendosje ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-007 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën IV të dispozitivit, u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç ‘rast paditëseve iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 498.20€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20,00.-€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 208,00.-€, si dhe përfaqësimin e të autorizuarit të paditësve në një seancë shumën prej 270.20.-€ të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 7).

Prandaj, gjykata bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.934/21 me datë 13 qershor 2022

Gj y q t a r e,  
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.